

NOTE INFORMUESE

Tiranë, më 03.11.2021

Mbi kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për procedim disiplinor me masën “vërejtje publike” për magistraten O.T.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka përfunduar hetimin disiplinor, i nisur me iniciativë ndaj magistrates O.T. me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, bazuar në indicjen e paraqitur pranë ILD nga emisioni investigativ “Stop”, në TV Klan, si dhe bazuar në të dhënat e marra nga verifikimi i kryer. Emisioni investigativ ka transmetuar në tetor 2020, rastin e vrasjes së një 18 vjecari në qytetin e Korcës (ngjarje e ndodhur në 14 qershor 2018), dhe pretendimet e familjarëve, se çështja është tjetërsuar përmes manipulimit të vrasjes, si një vetëvarje. Familjarë të viktimës ngrenë pretendime, se prokurorja O.T., që mori çështjen pas vendimit të gjykatës për hetime të mëtejshme të rastit, nuk ka kryer hetime, por e ka zvarritur çështjen, dhe mbyllur e klasifikuar si vrasje. Gjykata ka kërkuar sërish hetime të mëtejshme për rastin.

Nga hetimi disiplinor i kryer nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, provohet se:

- Magistratja ka zvarritur në mënyrë të pajustificuar veprimet dhe aktet procedurale lidhur me rastin, duke mos ndërmarrë veprimet përkatëse, në njoftimin e familjarëve të viktimës për të drejtat që u njeh ligji, si dhe ka vonuar pa shkak dërgimin e çështjes në gjykatë. Kjo vonesë është bërë tej afatit të arsyeshëm, për një periudhë 6 muaj e 25 ditë, që parashikohet, si shkelje disiplinore (neni 102 pika 1 shkronja “d” e ligjit me nr.96/2016).
- Mosndërmarrja e këtyre veprimeve përbën mospërmbushje të detyrës së prokurorit, të cilit i është dhënë atributi kushtetues, për të ushtruar ndjekjen penale dhe për të proceduar me vendim/kërkesë, e cila në vazhdim i nënshtrohet kontrollit gjyqësor.
- Nga ana e prokurores, gjatë hetimit disiplinor të ILD-së, nuk është arritur të justifikohet zvarritja e konstatuar. Rezulton se përgjatë periudhës kohore, në të cilën është konstatuar kjo zvarritje, prokurores i janë drejtuar edhe dy kërkesa me shkrim nga ana e familjarëve të viktimës, ku i kërkohet informacion mbi fazën e procedimit, dhe sërish nga ana e prokurores nuk është vepruar për ezaurimin e njoftimit për përfundimin e hetimeve dhe dërgimit të çështjes në gjykatë, me kërkesën përkatëse.
- Mosndërmarrja e këtyre veprimeve brenda një kohe të arsyeshme janë të dhëna që tregojnë se magistratja ka vepruar me faj në formën e dashjes.
- Veprimet e mosveprimeve të magistrates O.T. kanë sjellë pasoja për dhënien e drejtësisë, cënimin e prestigjit të prokurorit, si dhe kanë cënuar besimin e publikut te drejtësia.

Duke mbajtur në konsideratë edhe përvojën 2 vjeçare në funksionin e prokurores Inspektori i Lartë i Drejtësisë i propozon Këshillit të Lartë të Prokurorisë caktimin ndaj prokurores O.T. të masës disiplinore “Vërejtje publike” për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 102, pika 1 shkronjat “d” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar